

VENDIM
Nr.314, datë 25.3.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS LUZ I VOGËL, TË QARKUT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Luz i Vogël, të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Luz i Vogël, të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.421, datë 8.4.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Luz i Vogël të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Luz i Vogël për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Luz i Vogël

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1,2,3,5,6,8,10,11,12	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
4,7,9,13,402,404,407,409, 411,414,417,419	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka jo produktive dhe kanale të treta).	Në pronësi
14-20	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e mbrojtjes civile.	Në pronësi
21-22	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
24	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim

25,65-398	Infrastrukturë (sheshe, lulishte dhe shërbime publike), rrugë vendore	Në pronësi
26-30	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik.	Në pronësi
31-36	Varrezat publike	Në pronësi
37-43	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
44-46	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e administratës.	Në pronësi